


1399/ke 01-04-2026



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 01.04.2026, merr këtë:

VENDIM NR.12/2026/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 11.03.2026

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 11.03.2026.

Neni 2


Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 11.03.2026.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milorad Dimitrijević

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 11.03.2026 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se të gjithë 19 këshilltarët janë të pranishëm në mbledhje dhe se ka kuorum. Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e KFOR-it, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimi, drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, kryetari i Kuvendit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike “Ekologjia”, kryesuesi i Komitetit për Komunitete (mandati 2022-2025), mediat, Shërbimi i Përkthimit, Shërbimi i Informimit dhe Shërbimi i Çështjeve të Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi këshilltarët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se Komiteti dha njëzëri mendimin pozitiv për rendin e propozuar të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës e hodhi në miratim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 këshilltarëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt, e mbajtur më datën 10.02.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (*Slaviša Ničić*).
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e Aneksit D të Kontratës për ofrimin e shërbimeve midis Komunës së Graçanicës dhe NKP “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me propozim të kryetarit të Kuvendit të Aksionarëve të NKP “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Sasha Daniq (*Saša Danić*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për vitin 2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq (*Brankica Ničić*).
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimi për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimi, Nebojša Millovanović (*Nebojša Milovanović*).

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (**Milan Dimitrijević**).

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, të mandatit 2022-2025, Aziz Karadollami.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt, e mbajtur më datën 10.02.2026.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (**Sllavisha Ničić**).

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se në raport shihet se janë shpenzuar gjithsej 9,848.860 €, nga të cilat 6,998.490 € janë grantet qeveritare, 2,850.060 € të hyrat vetanake, ndërsa 320 € donacionet. Pjesa e dytë e tabelës i referohet kategorive ekonomike, ku është shpenzuar kjo shumë dhe ajo tregon se 4,511.180 € janë shpenzuar për paga dhe mëditje, 1,932.530 € për mallra dhe shërbime, 248.860 € për shërbime komunale, 600.100 € për subvencione dhe 2,566.190 € për investime kapitale. Buxheti fillestar për të hyrat ishte 2,729.210 €, buxheti final 2,729.210 €, ndërsa janë realizuar 2,620.780 €, gjë që tregon se nuk i kemi realizuar të hyrat e planifikuara vetanake. Buxheti fillestar total ishte 9,753.350 €, buxheti final 10,824.740 €, ndërsa janë shpenzuar 9,848.860 €.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e Aneksit D të Kontratës për ofrimin e shërbimeve midis Komunës së Graçanicës dhe NKP “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me propozim të kryetarit të Kuvendit të Aksionarëve të NKP “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Sasha Daniq (**Sasha Danić**).

Kryetari i Kuvendit të Aksionarëve të NKP “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Sasha Daniq, tha se Kuvendi i Aksionarëve e shqyrtoi dhe e pranoi vendimin e Bordit të drejtorëve për të ndryshuar Shtojcën D të Kontratës për ofrimin e shërbimeve komunale për: mirëmbajtjen e varrezave, sipërfaqeve të gjelbra publike dhe parqeve. Propozimi është që çmimi i shërbimit të lartpërmendur të ndryshohet nga 0.12 € që ishte më parë në 0.20 €, duke marrë parasysh rritjen e ndjeshme dhe të vazhdueshme të kostove operative në periudhën e mëparshme dhe në veçanti rritjen e: çmimit të karburantit, deponimit të mbeturinave në deponinë rajonale, pjesëve rezerve, si dhe rritjen e pagës së punonjësve në pagën minimale në një shumë prej 500.00 € bruto.

Këshilltari i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Albert Vllahu, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se ai nuk ka asgjë kundër rritjes së çmimit, por kërkoi që cilësia e shërbimeve të jetë në përputhje me rritjen e çmimit. Ai u tregoi këshilltarëve fotografitë e deponive të paligjshme të mbeturinave në Uglar, Lepinë dhe Suhadoll dhe kërkoi që NKP “Ekologjia” t’i pastrojë ato si dhe të vendosen tabelat në të njëjtat vendet që ndalojnë hedhjen e mbeturinave në këto sipërfaqe, si dhe që varrezat e të gjitha komuniteteve në territorin e Komunës së Graçanicës të mirëmbahen më rregullisht.

Kryesuesi i sugjeroi këshilltarit Vllahu që kërkesën për largimin e deponive të paligjshme t’ia dërgojë së pari Ekologjisë, ndërsa Kuvendi i komunës do ta monitorojë realizimin e kërkesës në fjalë dhe do të reagojë nëse ato deponi të paligjshme nuk largohen. Ai e informoi këshilltarin se në mandatin e kaluar kishin probleme me kamionët që vinin nga komunat e Lipjanit, Prishtinës dhe Fushë Kosovës që i shkarkonin mbeturinat në territorin e Komunës së Graçanicës. Gjithashtu, në rrugët lokale ishin të vendosura tabelat që ndalonin kalimin e kamionëve që peshonin më shumë se 10 ton, por as kjo nuk është respektuar.

Këshilltari i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Bekim Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se në kodrën midis Kishnicës dhe Sushicës, kamionët po hidhnin mbeturina dhe ai kërkoi një zgjidhje lidhur me këtë.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, pyeti nëse e njëjta kërkesë që do t’i dërgohet Ekologjisë mund t’i dërgohet edhe Kuvendit të komunës.

Kryesuesi u përgjigj se kërkesa duhet t’i dërgohet Ekologjisë dhe Drejtorisë së Inspektionit, ndërsa ne do të kërkojmë një raport prej tyre se çfarë kanë bërë lidhur me atë kërkesë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 18 këshilltarëve “Pro” dhe 1 “Abstenim” nga Lumnije Gashi (për shkak të konfliktit të interesit, ajo nuk votoi sepse punon në “Ekologji”), miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapì diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për vitin 2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq (*Brankica Niić*).

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq, tha se çdo vit drejtorja, në përputhje me planin buxhetor, investon në projekte kapitale, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe ofron mbështetje logjistike për të gjitha institucionet arsimore në komunë. Për vitin 2025, projektet më të rëndësishme kapitale ishin ndërtimi i një depoje për institucionin parashkollor “Gjurgjevak” dhe ndërtimi i një objekti ndihmës për ruajtjen e drurëve të zjarrit në shkollën në Lepinë. Fondi për shërbimet komunale arrin në 40.000 €, nga ky fond, kryesisht janë paguar faturat për energjinë elektrike dhe ujin e konsumuar për institucionet arsimore, qendrat kulturore dhe objektet sportive. Një nga aktivitetet e drejtorisë sonë është pranimi i kërkesave për nostrifikimin e diplomave nga Universiteti Mitrovicës së Veriut, kështu që në vitin 2025 u

pranuan rreth 25 kërkesa, ndërsa Komisioni i përpunoi 10. Gjysmëvjetori i parë në shkolla përfundoi sipas planit të përcaktuar, në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe përfundoi më 30.12.2025, ndërsa në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe përfundoi më 24.12.2025. Gjysmëvjetori i dytë për nxënësit që ndjekin mësim në gjuhën serbe filloi më 19.01.2026, ndërsa për nxënësit që ndjekin mësim në gjuhën shqipe më 08.01.2026.

Këshilltari Dragan Millovanoviq, para partisë “Lista Serbe”, e vlerësoi raportin e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe pyeti se kur është në plan të rindërtohet salla e mbyllur në Gushtericën e Poshtme.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se buxheti për vitin 2026 përfshin rindërtimin e sallës së mbyllur dhe shpreson se mund ta realizojnë atë këtë vit.

Këshilltari i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Albert Vllahu, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se kanë një kërkesë nga drejtori i shkollës “Ditët e Minatorit” në Kishnicë për pagesën e faturës për largimin e mbeturinave.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se komuna nuk ka mjete të mjaftueshme për pagimin e faturave për mbledhjen e mbeturinave dhe shkollave në Komunën e Graçanicës nuk i paguhen këto fatura.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve, Nebojsa Millovanoviq (*Nebojša Milovanović*).

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve, Nebojsa Millovanoviq, duke prezantuar raportin e punës, theksoi disa projekte kryesore të realizuara gjatë vitit të kaluar. Një nga projektet kryesore ishte pajisja e kabineteve të kimisë, biologjisë, fizikës, matematikës dhe gjeografisë në Shkollën fillore “Kralj Milutin” në Graçanicë. Vitin e kaluar, së bashku me Ambasadën e Japonisë, arritëm të sigurojmë mjete për blerjen e dy pajisjeve, një analizues imunologjik dhe një pajisje për fiziatri në Qendrën diagnostike në Graçanicë, vlera e projektit ishte 59.700 €.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Lumnije Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare”, e pyeti drejtorin nëse mund t’ia dërgonte listën me bazën e të dhënave të bizneseve që gjenden në territorin e Komunës së Graçanicës.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve, Nebojsa Millovanoviq, u përgjigj se do t’ia dorëzonte.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (**Milan Dimitrijević**).

Kryesuesi shpjegoi se në njërën nga mbledhjet e mëparshme ata e kishin miratuar Vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, por MAPL-ja vlerësoi se vendimi nuk është në përputhje me nenin 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Më 2 shkurt, Kuvendi i dërgoi një kërkesë MAPL-së, duke kërkuar sqarime për numrin e anëtarëve të Komitetit dhe nëse shumica e thjeshtë duhet të përbëhet nga këshilltarët e Kuvendit të komunës apo nga anëtarët e komuniteteve jo-shumicë. Më 3 mars, MAPL-ja iu përgjigj kërkesës dhe sqaroi se Komiteti i Komuniteteve përbëhet nga anëtarët e Kuvendit të komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve, siç përcaktohet në nenin 53. Kryesuesi propozoi Millën Zhivkoviq dhe Millosh Dimiqin për të plotësuar dy anëtarë të Komitetit nga Lista Serbe dhe nëse ndonjë grup këshilltarësh ka propozim të vet, mund ta paraqesë atë. Me këtë propozim, respektojmë se nga 11 anëtarët e Komitetit të Komuniteteve, 6 janë anëtarë nga komunitetet pakicë dhe 6 janë këshilltarë të Kuvendit të komunës.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Lumnije Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se nëse Komiteti i Komuniteteve duhet të plotësohet me dy këshilltarë të tjerë, ajo propozoi që të jetë një këshilltar shqiptar dhe një këshilltar nga komuniteti serb.

Kryesuesi u përgjigj se ligjërisht të dy anëtarët mund të jenë nga komuniteti serb, sepse nga 6 anëtarët e komuniteteve pakicë, përfaqësohen 2 anëtarë të komunitetit shqiptar, 1 prej të cilëve është këshilltar dhe 1 është përfaqësues i komunitetit.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Lumnije Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare”, propozoi Albert Vllahiun si anëtar të Komitetit të Komuniteteve.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e parë që Komiteti për Komunitete të plotësohet me dy anëtarë, këshilltarë të Kuvendit të komunës, Milla Zhivkoviq dhe Milosh Dimiq.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 12 këshilltarëve “Pro”, miratoi propozimin e parë..

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dytë që Komiteti për Komunitete të plotësohet me një anëtar, këshilltarin e Kuvendit të komunës, Albert Vllahiu.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 4 këshilltarëve “Pro”, nuk e miratoi propozimin e dytë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 12 këshilltarëve “Pro” dhe 4 vota “Kundër” të Albert Vllahiut, Lumnisë Gashi, Bekim Gashit dhe Aidës Qerkini dhe 3 vota “Abstenim” të Marijës Steviq, Ivanës Vujoviq dhe Nikolla Rashiqit, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës dhe e plotësoi Komitetin për Komunitete me dy anëtarë – këshilltarë të Kuvendit, Milla Zhivkoviq dhe Millosh Dimiq, kështu që Komiteti për Komunitete përbëhet nga 11 anëtarë të mëposhtëm:

1. Turkijan Tairi, përfaqësues i komunitetit rom,
2. Enes Sopjani, përfaqësues i komunitetit shqiptar,
3. Mersiha Bajrami, përfaqësuese e komunitetit goran,
4. Aziz Karadollami, përfaqësues i komunitetit boshnjak,

5. Florim Bajrami, përfaqësues i komunitetit ashkali,
6. Bojana Mitiq, këshilltare e KK të Graçanicës,
7. Bobana Jovanoviq Trajkoviq, këshilltare e KK të Graçanicës,
8. Lumnije Gashi, këshilltare e KK të Graçanicës,
9. Nikolla Rashiq, këshilltar i KK të Graçanicës,
10. Milla Zhivkoviç, këshilltare e KK të Graçanicës,
11. Millosh Dimiq, këshilltar i KK të Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, të mandatit 2022-2025, Aziz Karadollami.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete (mandati 2022-2025), Aziz Karadollami, duke prezantuar raportin e punës, theksoi se në vitin 2025 Komiteti për Komunitete mbajti 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Në mbledhjet, anëtarët kanë diskutuar për situatën në komunitetin e tyre, problemin e derdhjes së ujërave të zeza në lagjen rome dhe është kërkuar komunikimi më i madh me përfaqësuesit e Këshillave lokale dhe drejtorët, me qëllim të zgjidhjes së problemeve në kohë. Është paraqitur problemi i rrjedhjes së një gypi të ujësjellësit, i cili rezultoi në dëmtimin e asfaltit, ndërsa nga Drejtoria e Arsimit janë marrë informacionet e kërkuara lidhur me transportin e nxënësve në komunat e Lipjanit dhe Graçanicës. Gjithashtu është kërkuar sigurimi i transportit ndërkomunal për nxënësit që ndjekin mësim në ato komuna. Është diskutuar edhe situata e sigurisë në Komunën e Graçanicës dhe është kërkuar kontrolli i shtuar policor. Në njërin nga mbledhjet, banorët e Preocit janë ankuar për problemin e kamionëve me kapacitet mbajtës mbi 10 ton që kalojnë, si dhe është theksuar problemi i trafikut dhe sinjalistikës rrugore. U vu në dukje problemi me shënimin e vendkalimeve për këmbësorë, si dhe u ngrit nevoja për instalimin e shenjës së trafikut për arsye sigurie. Në mbledhje janë prezantuar informacionet rreth fillimit të vitit shkollor, si dhe janë diskutuar problemet me qentë endacakë dhe lidhur me këtë është dërguar një kërkesë drejtorisë përkatëse.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Të ndryshme.


Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë “Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetësë”, pyeti nëse komuna do të sigurojë një parcelë për NPK “Ekologjia”, sepse parcela që ata aktualisht po e përdorin pranë Qendrës së shkollave të mesme në Llapllasellë nuk është e përshtatshme.


Kryesuesi u përgjigj se Komuna e Graçanicës i kishte ndarë një parcelë për NPK “Ekologjia”, por Qeveria e Kosovës mori një vendim dhe e caktoi të gjithë zonën ku ndodhet dhe atë parcelë për ndërtimin e Qendrës për “Jetimet e Ballkanit”. Komuna iu drejtua Gjykatës Kushtetuese dhe gjykata lëshoi një masë të përkohshme duke pezulluar ndërrimin e destinimit të

asaj toke, por në të njëjtën kohë ne nuk mund ta japim të njëjtën tokë në shfrytëzim sepse është në kontest.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 12:03.

Procesmbajtësi
Agron Karadollami





Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës


Milan Dimitrijević